



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

***Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre***

Adresa: Bulevardi: “Zhan D’Ark” Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K3/ I8-5 Prot.

Tiranë 12/12/ 2023

Nr. Dok. 202300069 /5

Lënda : *Kërkesë për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të Bashkisë Malësi e Madhe, për moskthim përgjigje.*

BASHKISË MALËSI E MADHE
Z. T.M, Kryetar

**KOPLIK, QENDËR ,
MALËSI E MADHE**

Të nderuar!

Institucioni i Avokatit të Popullit, në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve nga veprimet ose mosveprimet e organeve të administratës publike, duke marrë shkas nga njoftimet në median on line,¹ me titull: “Mbeturinat mbushin lagjen Pigza në Koplik”, ka ndërrmarë për shqyrtim rastin, me iniciativë ².

¹ Linku: <https://fb.watch/h-OJx3cr-d/>

² neni 13/3 i ligjit Nr 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Konkretisht :.....” Mbetjet të cilat sipas një banoreje atje nuk janë pastruar prej shumë kohësh vijnë nga i gjithë qyteti i Koplikut, duke i hedhur aty. Banorja thotë se është e pamundur të hapin dritaret e shtëpive që janë afër, pasi mbeturinat ndodhen në rrugën kryesore të lagjes “Pigza”, në Koplik. Banorja i bën apel Bashkisë Koplik që të ndërhyjë për pastrimin e mbeturinave, sepse situata në lagjen “Pigza” sipas saj është rënduar tepër, duke rrezikuar edhe përhapjen e infeksioneve. Përveç dëmeve shëndetësore, prania e këtij grumbulli mbeturinash ndot edhe mjedisin e lagjes “Pigza” të Koplikut në Malësinë e Madhe. Disa herë banorët kanë kërkuar pastrimin e asaj zone, por deri më tani , bashkia e Malësisë së Madhe nuk ka marrë masat e duhura”.

Në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor, e konkretisht nenit 63/4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: *“Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”*, si dhe nenit 19 /b të Ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”*, në vijim të hetimit administrativ me qëllim sqarimin e fakteve e të rrethanave, i jemi drejtuar me disa shkresa Bashkisë Malësi e Madhe, por nuk kemi marrë asnjë përgjigje.

Konkretisht kemi dërguar shkresën e parë me Nr. K3/ I8-2 prot., datë 26.01.2023, *“kërkesë për shpjegime”*. Në kushtet kur Bashkia Malësi e Madhe nuk iu përgjigj kërkesës së Avokatit të Popullit, ju jemi ridrejtuar sërish me shkresat Nr. K3/ I8-3 prot., datë 11.04.2023 dhe Nr. K3/ I8-4 prot., datë 04.07.2023 *“Kërkesë e përsëritur për shpjegime”*. Në zbatim të nenit 19/2 të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme”*, kemi kërkuar që informacioni i kërkuar të na vihet në dispozicion brenda një afati prej 10 (dhjetë) ditësh nga marrja e kësaj shkrese. Por ju bëjmë me dije se përsëri nuk është kthyer përgjigje, edhe pse ka kaluar afati i përcaktuar si dhe çdo afat i arsyeshëm kohor.

Në rrethanat e parashtruara sa sipër ju bëjmë me dije se kjo situatë përbën shkelje flagrante të Kodit të Procedurave Administrative, duke mos zbatuar dhe cënuar rëndë parimin e respektimit të hierarkisë institucionale dhe bashkëpunimit ndërinstitutional. Mosdërgimi i përgjigjes së kërkuar ka sjellë si pasojë mos trajtimin e kësaj ankese brenda afatit ligjor dhe mungesën e

korrektesës së institucionit tonë ndaj ankuesit. Ky qëndrim i mbajtur nga organi juaj me institucionin tonë ka sjellë pengesë në kryerjen e misionit kushtetues e ligjor të Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave, lirive të shtetasve dhe interesave të tyre të ligjshme, si dhe në kthimin në kohë të përgjigjes ankuesit.

Ndërkohë kjo sjellje, cënon rëndë marrëdhëniet tona institucionale, si dhe dëmton imazhin e institucionit të Avokatit të Popullit në publik. Mosdhënia e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar, përbën shkelje të parimeve kushtetuese dhe ligjore. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 63 të saj e ka ngritur në nivel kushtetues detyrimin e organeve të administratës shtetërore dhe funksionarëve publikë, për bashkëpunim me institucionin e Avokatit të Popullit dhe të drejtën e këtij të fundit për të kërkuar informacion e dokumentacion. Neni 63 përcakton se: *“Avokati i Popullit paraqet raport vjetor përpara Kuvendit. 2. Avokati i Popullit raporton përpara Kuvendit kur i kërkohet prej këtij, si dhe mund t’i kërkojë Kuvendit të dëgjohet për çështje që ai i çmon të rëndësishme. 3. Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike. 4. **Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”.***

Pra, parimi i bashkëpunimit në këtë rast është kushtetues dhe detyrues për të gjitha organet e administratës shtetërore, duke i detyruar ato t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, pa përjashtime. Rëndësia e këtij parimi konstatohet edhe në instrumentat ligjore që kushtetuta i ka vënë në dispozicion Avokatit të Popullit, në rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut apo mosrespektimit të parimit të bashkëpunimit nga organet e administratës publike apo funksionarët publikë. Neni 63 pika 1, 2 dhe 3 e tij parashikojnë instrumenta të tilla ligjore, në dispozicion të Avokatit të Popullit, si raportet vjetore dhe ato të veçanta, rekomandimet apo propozimi për marrjen e masave administrative ndaj nëpunësve përgjegjës. Gjithashtu, edhe ligji nr.8454/1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, parashikon të drejtën e institucionit tonë për marrjen e masave administrative në rast të refuzimit për bashkëpunim nga organet e administratës publike apo nëpunësit e tyre. Në mënyrë eksplicite kjo është sanksionuar në nenin 22 të këtij ligji në të cilin është parashikuar se : *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”.*

Parimi i bashkëpunimit mes organeve të administratës publike është sanksionuar si në Kodin e Procedurës Administrative ashtu dhe në ligjin Nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore". Neni 3 i këtij të fundit përcakton se: "*Administrata shtetërore organizohet dhe funksionon sipas parimeve të: unitetit dhe hierarkisë; llogaridhënies; dekoncentrimit; qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit, si dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore. Sipas parimit të bashkëpunimit, organet, institucionet dhe njësitë administrative, si dhe nëpunësit publikë, në të gjitha nivelet e administratës, bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me organet e institucioneve të pavarura, për arritjen e objektivave ligjore që u janë besuar, në përputhje me ligjin*". Duhet theksuar se Avokati i Popullit është institucion kushtetues, i cili ka rol "kontrollues" mbi veprimtarinë e organeve të administratës publike në lidhje me zbatimin e respektimin e të drejtave kushtetuese, duke ndihmuar individët që t'u krijojnë shanse të barabarta, të mund të trajtohen si të barabartë në çdo marrëdhënie me administratën publike, përveç gjykatave.

Legjislatori ka paraparë si veçori themelore të institucionit të Avokatit të Popullit, veç pavarësisë nga institucionet e tjera dhe nga çdo ndikim politik, lehtësinë e kontaktimit, shpejtësinë dhe fleksibilitetin në kapjen e problemeve, si dhe mungesa e shpenzimeve, pasi veprimtaria e tij është pa pagesë. Mungesa e informacionit dhe dokumentacionit, si dhe dërgimi i përgjigjeve të pjesshme apo tej afatit të përcaktuar dhe atij të arsyeshëm ligjor, sjell zvarritjen e procesit administrativ dhe mohimin e të drejtës së qytetarëve për të gëzuar efektivisht të drejtat e tyre kushtetuese dhe për të përdorur mekanizmat kushtetues për garantimin e tyre. Kjo gjithashtu minon besimin e qytetarëve tek shteti dhe administrata shtetërore ndërkohë që të gjitha përpjekjet në nivel evropian por edhe të Këshillit të Evropës janë të drejtuara për nga ruajtja e besimit të publikut dhe përmirësimi i këtij indikator.

Megjithatë, krahas detyrimit të përgjithshëm për informim dhe transparencë që kanë organet publike përkundrejt palëve të treta, theksojmë se detyrimi për bashkëpunim me Avokatin e Popullit gjatë hetimit administrativ, veçse një detyrim i karakterit administrativ, është një detyrim Kushtetues, për nga vetë specifika që ka ky organ publik. Bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies. Organet e administratës publike janë të detyruara të bashkëpunojnë për të mbështetur organin publik që kryen hetimin administrativ në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes.

Transparenca dhe llogaridhënia janë dy nga parimet kryesore të mirëqeverisjes në administratën publike. Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike sa i përket ushtrimit të veprimtarisë administrative nga ana e tyre.

Gjithë sa përshkruam më lart, evidentohet lehtësisht neglizhenca apo mungesa e bashkëpunimit të këtij institucioni, thjesht duke parë afatin apo datën kur kemi kërkuar informacion, që i përket datës 26.01.2023, ndërkohë akoma nuk kemi një përgjigje prej tij (përreth 10 muaj).

Referuar problematikës së hasur në këtë rast, me personat përgjegjës në respektim të afateve procedurale të kthimit të përgjigjes, institucioni i Avokatit të Popullit kërkon nga Bashkia Malësi e Madhe, titullari i këtij institucioni, të vlerësojë në përputhje me ligjin **organik dhe Kodin e Procedurave Administrative, veprimtarinë e personave përgjegjës mbi respektimin e afateve procedurale në shqyrtim të akteve si dhe ofrimin e shërbimeve konform legjislacionit aktual.**

Për këto arsye, bazuar në nenin 22/1 të ligjit “Për Avokatin e Popullit” ku parashikohet se: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”,*

REKOMANDOJMË:

- Fillimin e procedurës administrative, për evidentimin e punonjësve përkatës përgjegjës, të Bashkisë Malësi e Madhe, lidhur me mospërmblidhjen e detyrimit ligjor, për t'i kthyer përgjigje kërkesave të Avokatit të Popullit, për dërgimin e informacionit të kërkuar, si dhe marrjen e masave administrative e disiplinore ndaj tyre.
- Marrjen e masave organizative që kjo shkelje të mos përsëritet në të ardhmen.
- Për qëndrimin që do të mbani ndaj kësaj kërkesë si dhe masat disiplinore që do të merrni, na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh, konform nenit 22 të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj!

Në mungesë dhe me Urdhër

K O M I S I O N E R

AHMET PRENÇI

d.v

